



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 259, Datë 17.12.2018**

**MBI**

**PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ROBERTO OIL” SH.A., PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 42 pika 1, gërma “dh” e Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 5 gërma “dh”, nenit 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, gërma “d”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 58, datë 18.04.2017, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Roberto OIL” sh.a për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike

**Konstatoi se :**

- ERE me Vendim të Bordit të Komisionerëve nr. 49, datë 17.04.2015, ka licencuar shoqërinë “Roberto OIL” sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a., me email-in e datës 13.11.2018, protokolluar në ERE, me nr. 727 Prot, datë 13.11.2018, ka kërkuar revokimin e licencës pasi nuk ushtron aktivitetin tregtar, për të cilën është licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë.
- ERE me shkresën nr.722/1 Prot, datë 21.11.2018, i është drejtuar shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., ku i ka kërkuar saktësimin e objektit të kerkimit, duke qënë se nga përmbajtja e email nuk del e qartë se cilën nga licencat kërkoni të hiqet, pasi subjekti disponon dy licenca, si dhe ka kërkuar paraqitjen e vendimit të miratuar nga organet drejtuese të shoqërisë, për heqjen e licencave respektive.
- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a. me email-in e datës 03.12.2018, protokolluar në ERE me nr. 722/2 Prot., datë 03.12.2018, ka përcjellë vendimin nr. 5 Prot, datë 09.11.2018, e ortakut të vetëm të shoqërisë, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 278, Seria T15, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 49, datë 17.04.2015.
- Shoqëria “Roberto OIL” sh.a. ka kryer pagesën e rregullimit, për vitet 2015; 2016; 2017, në pajtim me pikën 3.8 të kushteve të Licencës, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Kërkesa për heqjen e licencës sipërcituar, vjen si rezultat i

mos ushtrimin të veprimtarisë, për të cilën është licencuar shoqëria “Roberto OIL” sh.a. dhe i drejtohet ERE-s nën vullnetin e saj të plotë.

- Kërkesa e shoqërisë “ROBERTO OIL” sh.a, për heqjen e licencave së tregtimit vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në të cilin citohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit; si dhe nenit 5, gërma “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 18.04.2017, të Bordit të ERE.*
- Po ashtu në paragrafin 2, të nenit 7 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, përcaktohet se: *“Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje.”*
- Neni 9 “Vendimet e Bordit”, i kësaj rregullore në gërmën “d” të saj, përcakton se: *“...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe / ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.”*
- 

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “ROBERTO OIL” sh.a., për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 278, Seria T15, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 49, datë 17.04.2015.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**